



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT KUKËS

Nr. 34 Prot.

Kukës më 4.1.2024

URDHËR

Nr. 1 datë 4 / 1 / 2024

PËR

NGRITJEN E KOMITETIT RAJONAL PËR PARANDALIMIN E RADIKALIZMIT DHE
LUFTËS KUNDËR EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM

Në zbatim të ligjit nr. 107/ 2016 “ Për Prefektin e Qarkut”, të Urdhërit nr.185 datë 31.10.2023 të Kryeministrit “Për ngritjen dhe funksionimin e komiteteve rajonale për parandalimin e radikalizmit dhe luftës kundër ekstremizmit të dhunshëm”,

URDHËROJ:

1. Ngritjen e Komitetit Rajonal për Parandalimin e Radikalizmit dhe Luftës kundër Ekstremizmit të Dhunshëm në Qarkun Kukës.

2. Komiteti të ketë në përbërje:

- | | |
|---|---------|
| a) Prefektin e Qarkut Kukës | Kryetar |
| b) Drejtorin e Drejtorisë Vendore të Policisë Kukës; | Anëtar |
| c) Drejtorin e Drejtorisë Vendore të Kufirit dhe Migracionit Kukës; | Anëtar |
| d) Drejtorin e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Kukës; | Anëtar |
| e) Drejtorin e Drejtorisë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive. | Anëtar |
| f) Drejtorin Rajonal të Shërbimit Informativ të Shtetit; | Anëtar |
| g) Drejtorin e Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale; | Anëtar |
| h) Drejtorin e Degës Territoriale të Shërbimit të Provës Kukës; | Anëtar |
| i) Drejtorin e Zyrës Vendore Arsimore Parauniversitare Kukës; | Anëtar |
| j) Drejtorin e Zyrës Vendore Arsimore Parauniversitare Tropojë; | Anëtar |
| k) Drejtorin e Zyrës Vendore Arsimore Parauniversitare Has; | Anëtar |
| l) Drejtorin e Njesisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Kukës; | Anëtar |
| m) Drejtorin e Njesisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Tropojë; | Anëtar |
| n) Drejtorin e Njesisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Has; | Anëtar |
| o) Përgjegjësin e Sektorit të Inspektoriatit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore Kukës; | Anëtar |
| p) Shefin e Seksionit të Policisë Kriminale në Policinë Ushtarake; | Anëtar |

- 3) Komiteti Rajonal për Parandalimin e Radikalizmit dhe Luftës kundër Ekstremizmit të dhunshëm në Qarkun e Kukësit është autoritet përgjegjës për referimin e rasteve të mundshme të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.
- 4) Komiteti Rajonal për Parandalimin e Radikalizmit dhe Luftës kundër Ekstremizmit të Dhunshëm zhvillon mbledhje periodike, 1 (një) herë në 3 (tre) muaj por edhe më shpesh në varësi të nevojave dhe problematikave.
- 5) Në mbledhjen e parë ky komitet miraton rregulloren e brendshme dhe sekretariatit teknik.
- 6) Pas çdo takimi të Komitetit Rajonal për Parandalimin e Radikalizmit dhe Luftës kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, sekretariati teknik raporton në mënyrë periodike pranë Koordinatorit Kombëtar për Parandalimin e Radikalizmit dhe Luftës kundër Ekstremizmit të Dhunshëm.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

